

FINANCA

Ditari Mujor | Shkurt 2024



Miratohet Akti Normativ për ndryshimin e buxhetit të vitit 2024

Këshilli i Ministrave ka miratuar Aktin Normativ për ndryshimin e buxhetit të vitit 2024. Në komunikimin me mediat pas mbledhjes së qeverisë, Ministri i Financave, Ervin Mete, u shpreh se përmes këtij Akti Normativ qeveria do t'i vijë në ndihmë sektorit fason, me Instrumentin e Garancisë së re Shtetërore prej 4 miliardë lekësh, në mënyrë që ky sektor të përballojë efektet e goditjeve si pasojë e faktorëve të jashtëm, të përmirësojë proceset teknologjike dhe të rrisë më tej produktivitetin. Ministri Mete informoi se Ministria e Financave ka rishikuar në rritje të ardhurat për vitin 2024, të cilat projektohen në rreth 687 miliardë lekë ose 28.2% e Produktit të Brendshëm Bruto, ndërsa në nivelin makro do të vijohet konsolidimi fiskal, duke projektuar një trend rënës të borxhit publik dhe një deficit më të ulët sesa projekzioni fillestar i buxhetit të këtij viti.

▶ LEXO MË SHUMË

Performanca Paraprake 12-Mujore e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Dhjetor 2023 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat tatimore dhe kontributet, për 12-mujorin 2023, u realizuan në masën 99.7% me planin e rishikuar në rritje me aktin normativ të buxhetit, si edhe në masën 101.3% me planin fillestar. Shpenzimet e përgjithshme publike për vitin 2023, arritën në rreth 674.7 miliardë lekë me një realizim në masën 96.6 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 95.6 përqind të planit vjetor të ndryshuar përmes Aktit Normativ nr.6, datë 14.12.2023 (AN nr.6). Krahasuar me vitin 2022 shpenzimet e përgjithshme publike rezultojnë 3.6 përqind më të larta ose 23.7 miliardë lekë më shumë. Niveli i deficitit për vitin 2023 rezultoi në masën 1.4% të PBB-së, krahasuar me 3.7% të PBB-së që ishte në vitin 2022.

▶ LEXO MË SHUMË



Ballkani Perëndimor drejt Tregut Unik të Pagesave në Euro (SEPA) – Mblidhen në Tiranë Ministrat e Financave dhe Guvernatorët e Bankave Qendrore

Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë organizuan në Tiranë Ministerialin "Ballkani Perëndimor drejt Tregut Unik të Pagesave në Euro (SEPA)". Ky Ministerial mbledhi Ministrat e Financave dhe Guvernatorët e Bankave Qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfaqësues të KE, BB dhe BERZH-it, e u mbajt në prag të Samitit të Liderëve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së për Planin e Rritjes. Si pjesë e këtij plani, KE ka identifikuar aksesin në SEPA (Single European Payment Area) si një nga mundësitë që vendet e BP mund ta përfitojnë përpara finalizimit të procesit të anëtarësimit, me përmbushjen e kushteve. Ministri i Financave, Ervin Mete, gjatë fjalës së mbajtur në Ministerial, u shpreh se integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në SEPA do të sillte përfitime të konsiderueshme ekonomike për rajonin. Sipas Ministrit, përfshirja në SEPA për vendet jo anëtare të BE-së përfaqëson një mundësi unike për Ballkanin Perëndimor që të ulë kostot e tregtisë dhe të pagesave si brenda rajonit, ashtu edhe me BE-në.

▶ LEXO MË SHUMË



Mbledhja e Konstituencës së FMN-së dhe BB-së mbahet për herë të parë në Shqipëri


Në datë 16 shkurt 2024 u mbajt për herë të parë në Shqipëri Mbledhja e Konstituencës së FMN-së dhe Grupit të BB-së Bankës Botërore. Në fokus të kësaj mbledhjeje ishin sfidat aktuale me të cilat po përballen ekonomitë e vendeve anëtare të kësaj konsistitence dhe përfaqesat sa më eficiente dhe të koordinuara me qëllim zhvillimin e tyre. Në fjalën e tij, Ministri i Financave u shpreh se Shqipëria rezultoi si një nga ekonomitë më rezistente në rajon dhe kjo qëndrueshmëri është inkurajuese edhe për perspektivën afatmesme dhe afatgjatë, si edhe për shëndetshmërinë e financave publike në vend. Mete vuri në dukje se borxhi publik jo vetëm që zbriti në nivelet e para krizave, por arriti nën 60% për herë të parë që nga viti 2011, duke shënuar një nivel prej 59.2% në fund të vitit 2023, sipas vlerësimeve më të fundit, duke e vendosur Shqipërinë ndër vendet që kanë ulur me ritmin më të shpejtë borxhin publik në rajon. Ministri Mete theksoi se po punohet për finalizimin e një strategjie të Menaxhimit të Financave Publike, në koordinim me Bashkimin Evropian, si një nga parakushtet themelore të avancimit me negociatat drejt BE-së.

▶ LEXO MË SHUMË

TË ARDHURAT TOTALE

për muajin e parë të vitit 2024 u realizuan në masën

54.35 miliardë Lekë



Performanca Paraprake e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për Janar 2024

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për muajin Janar 2024 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për muajin Janar 2024, u realizuan në masën 100.6% të planit të së njëjtës periudhë. Shpenzimet e përgjithshme publike, për muajin e parë të vitit 2024, arritën në rreth 38.6 miliardë lekë me një realizim në masën 89.2 përqind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ky zë ka rezultuar 10.3 përqind më i lartë ose rreth 3.6 miliardë lekë më shumë. Niveli i suficitit në muajin e parë të vitit 2024 rezultoi në rreth 15.8 miliardë lekë. Të ardhurat totale, për muajin Janar 2024 u realizuan në masën 54.35 miliardë lekë ose 100.6% e planit të së njëjtës periudhë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u mbledhën 4 miliardë lekë më shumë, ose 8% më shumë se në Janar 2023.

▶ LEXO MË SHUMË



"Inovacioni në Sistemin Financiar"

Ministri i Financave, Ervin Mete, mori pjesë në takim me temë "Inovacioni në Sistemin Financiar", ku u diskutua rreth çështjeve dhe sfidave lidhur me zhvillimet inovative në sektorin financiar. Në fjalën e tij, Ministri Mete u shpreh se digjitalizimi dhe qasja ndaj teknologjisë tashmë është kthyer në një objektiv kryesor dhe ndërsektorial jo vetëm në vendin tonë, por edhe në mënyrë në nivel evropian apo botëror, sidomos pas pandemisë Covid-19. Ministri solli në vëmendje disa prej zhvillimeve pozitive të shënuara në sektorin financiar në vitet e fundit sa i përket digjitalizimit dhe theksoi faktin se inovacioni dhe digjitalizimi në këtë sektor i shërben jo vetëm zhvillimit të tij, por edhe ekonomisë në tërësi.

▶ LEXO MË SHUMË



Takim me Drejtorin Ekzekutiv të Bankës Shtetërore Italiane "Cassa Depositi e Prestiti" dhe Kryetarin e SIMEST SpA

Ministri i Financave, Ervin Mete, priti në një takim Drejtorin Ekzekutiv të Bankës Shtetërore Italiane "Cassa Depositi e Prestiti" (CDP), z. Dario Scannapieco, Kryetarin e SIMEST SpA, z. Pasquale Salzano dhe delegacionin që i shoqëronte. Ministri Mete vlerësoi marrëdhëniet shumë të mira ekonomike dhe tregtare mes Shqipërisë dhe Italisë, si edhe shprehu angazhimin për thellimin e mëtejshëm. Ministri theksoi se Shqipëria ofron mundësi për investime në sektorë si energjia, infrastruktura dhe turizmi, ndërsa shprehu gadishmërinë për të thelluar bashkëpunimin me Qeverinë italiane përmes përfshirjes më të gjerë të dy institucioneve financiare, CDP dhe SIMEST, përmes njohjes formale si institucione financiare për zhvillim.

▶ LEXO MË SHUMË